REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 330/20
Datë/Datum. 12.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Teuta Krasniqi	02.06.2020	12.06.2020	330/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.05.2020, ***OE"ALFA.I .SH.P.K-LIPJAN***, kanë parashtruar ankesë me nr: 330/20, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues , **lidhur me Projektin: ".SANIMI I DEMEVE DHE IZOLIMI KOMPLET I KULMIT TE PALESTRES SPORTIVE NE ISTOG.": me nr.prokurimit: 633-20-1203-5-2-1 dhe me numër të prokurimit te brendshem: 633-020-011-521 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KOMUNA E ISTOGUT.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **100.000,00€.**

Ankesa është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 330/20,

Dispozitat e shkelura sipas, grupit te OE"ALFA.I .SH.P.K-LIPJAN , te cilet kanë parashtruar ankesë me nr: 330/20, janë:

Neni 1 - I LPP-së
Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi,
Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - I LPP-së
Neni 64 - I LPP-së
Neni 69 - I LPP-së

pikat e ankesës:

Të nderuar me dt.08.05.2020

Të nderuar me dt.O8.05.2020, ne kemi pranuar letrën standarde nga AK-ja, ku jeni i shpallur si tenderues të pasuksesshëm, ndërsa është rekomanduar për kontratë OE NP Izolimi, i cili është i papërgjegjshëm:

Fillimisht ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar ISO certifikatën 9001:2015 dhe 14001:2015, ndërsa në nenin 9.1&9.2 të FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht kerkesa 9 është kërkuar: Kompania të jetë e certifikuar me ISO 14001:2015 për dysheme me Epoxid, ISO"9001:2015 shtruarja me Epoxid, ISO 9000:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 9004:2015 Menaxhimi i Cilësisë". Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar certifikatat të certifikuara me Epoxid, prandaj shihet qartë se OE i lartpërmendur nuk ka plotësuar kërkesën e lartcekur dhe është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 9.1&9.2 lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku tek kërkesal 2, 3 dhe 4 për inxhinier është kërkuar minimum 3 vite përvojë punë, ndërsa si dëshmi janë kërkuar letër referencat nga punëdhënësi për përvojën e punës, kurse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi si në vijim: Inxhinieri i arkitekturës z.Daut Ratkoceri nuk ka referenca për tri vite përvojë pune si inxhinier i arkitekturës, ashtu siç është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Inxhinieri i elektros z.Dijamant Selaj nuk ka referenca për tri vite përvojë pune si inxhinier i elektros, ashtu siç është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë. Inxhinieri i hidroteknikës z.Feriz Terstena nuk ka referenca për tri vite përvojë pune si inxhinier i Hidroteknikës, ashtu siç është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Pra pasi që në FDT dhe tek njoftimi për kontratë është kërkuar të dëshmohet përvoja e punës për inxhinier vetëm me referenca, gjë të cilën OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar, shihet qartë se ky OE është favorizuar në kundërshtiin me nenin 7 të LPP-së duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka përmbush të gjitha kërkesat e FDT dhe të njoftimit për kontratë.

Ne nie dt. 18.05.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore. Ndërsa sa i përket arsyes së refuzimil të kërkesës tonë për rishqyrtim AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore, duke thënë se AK-ja i ka respektuar Parimet themelore të Prokurimit Publik, mirëpo nuk ka ofmar asnjë fakt/dëshmi konkrete në lidhje me pretendimet tona. Andaj duke e parë përgjigjen e AK-së jep të kuptohet se autoriteti kontraktues po e dëshmon se pretendimet tona ankimore janë të bazuara dhe se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm sepse AK-ja nuk ka dhënë ndonjë dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë i plotësojnë kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i papërgjegjshëm.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Duke u bazuar në dëshmilë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "ALFA.I" SH.P.K

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERESTM dhe gjatë rivlerësimil, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-se.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detymar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

5. **Dëmet materiale**

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t 'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.
Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

KRITERET PËR VLERËSIM

1. Kërkesa 2 -Nje Menaxher kontrate - inxhinier I Arkitektures min 3 vite pervoj pune
2. Kërkesa 3 -Nje inxhinier te Elektroteknikes min 3 vite pervoj pune
3. Kërkesa 4 -Nje inxhinier te Hidroteknikes, min 3 vite pervoj pune

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 - Lista e kontratave duhet te dorzohet e skanuar origjinal-e nenshkruar dhe vulosur nga O.E., duke specifikuar emrin e projektit, shumen e kontrates, daten e fillimit +mbarimit te kontrates dhe referenca apo raporte te pranimit teknik. Referenca t apo raportet e pranimit teknik duhet te korrespondojne me listen e kontratave
Dëshmia 2 - Per menaxher te kontrates- diploma e skanuar origjinal-kopje e noterizuar, kontrata e punes apo parakontrata per projektin ne fjale, vendimi per caktimin e menaxherit dhe letër referencat për deshmi nga punedhenesi per pervojen e punes.
Dëshmia 3 - Diploma e skanuar origjinal-kopje e noterizuar, kontrata e punes apo parakontrata per projektin ne fjale,dhe letër referencat për deshmi nga punedhenesi per pervojen e punes.

Kërkesa 9 -Kompania te jete e qertifikuar me ISO 14001 2015 per Dysheme me Epoxid , ISO 9001 2015 Shtruarja me Epoxid , ISO 9000 2015 Sistemet e menaxhimit te Cilesise, ISO 9001 2015 Sistemet e menaxhimit te cilesise, ISO 9004 2015 Menaxhimi I Cilesise

Dëshmia 9 -Certifikatat e skanuara origjinal te nenshkruara dhe vulosura

Kriteret e Dhënies

Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni i Vlersimit ka rekomanduar për dhenje të kontrates ka rekomanduar Departamentin e Prokurimit për dhenje te kontrates.

Ndersa me daten 08.05.2020 Udhëheqsi i Departamentit të Prokurimit i AK- ka marr vendim që në bazë të raportit të vlersimit të publikoj njoftimin mbi vendimin e AK dhe të shperblej me kontrat OE- Halit S.Rama -Prishtinë

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

OE ankues është palë me interes,sepse i njejti është ofertues

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES-" OE- ALFA.I SH.P.K" -Ankesa 330/2020

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1 .

Operatori Ekonomik ankues " ALFA.I SH.P.K"-pretendon se „Komuna e Istogut '' nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është te sigurojë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE.fitues si OE i suksesëshëm pa u siguruar se i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe D. T. nuk është në harmoni me nenin 1 të LPP-së .

Andaj,
Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Operatori Ekonomik ankues " ALFA.I SH.P.K"-pretendon se Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Eksperja thekson se qellim i ketij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve .andaj trajtimi i OE.fitues si OE. i suksesëshum pa u siguruar se i ka plotsuar te gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. nuk është në harmoni me nenin 7 të LPP-së
Sepse nese OE. i shpallur fitues nuk mund të deshmojë se i posedon te gjitha çertifikatat ISO siq janë kerkuar me NJ.K. dhe D.T. i bjen se është favorizuar nga Autoriteti kontraktues dhe nuk është në harmoni me nenin 7 të LPP-së
Andaj,
Eksperja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Operatori Ekonomik ankues " ALFA.I SH.P.K"-pretendon se Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Eksperja thekson se qellim i ketij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
Fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit i cili ka konstatuar se OE.i shpallur fitues i ka plotsuar te gjitha kriteret e parapara ne FDT.

Kurse OE.ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk nuk i ka plotsuar keto kerkesa:

ISO certifikatën 9001:2015 dhe 14001:2015, ndërsa në nenin 9.1&9.2 të FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht kerkesa 9 është kërkuar: Kompania të jetë e certifikuar me ISO 14001:2015 për dysheme me Epoxid, ISO"9001:2015 shtruarja me Epoxid, ISO 9000:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 9004:2015 Menaxhimi i Cilësisë". Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar certifikatat të certifikuara me Epoxid, prandaj shihet qartë se OE i lartpërmendur nuk ka plotësuar kërkesën e lartcekur dhe është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE ankues pretendon se OE. i shpallur fitues nuk i ka plotsuar edhe kerkesat e parpara me nenin 9.1 dhe 9.2 lidhur me kerkesat mbi mundesit teknike dhe ose profesionale ku janë kerkuar disa ingjinier me pervojë profesionale .

Ekspertja thekson se OE. i shpallur fitues nuk i ka te gjitha çertifikatat e kerkuara me me ISO STANDARDE Ssiq janë NJ.K dhe D.T.
Ekspertja gjat ekzaminimit të dokumentacionit të OE fitues nuk ka hasur në keto çertifikata ISO 9000:2015 dhe ISO 9004:2015 .

Sa i perket pretendimit lidhur me mungesen e stafit të ingjinierve ky pretendim nuk qendron sepse OE.i shpallur fitues i ka plotsuar të gjitha kriteret sa i përket stafit të kerkuar për ma teper shih dokumentacionin e secilit nga stafi veq e veq .

Ekspertja pas shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit konstaton se pretendimi i OE .ankues është pjesërisht i bazuar lidhur me shkeljen e nenin 59 të LPP-së

Andaj,
Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Operatori Ekonomik ankues " ALFA.I SH.P.K"-pretendon se Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Eksperja thekson se qellim i ketij neni është të respektohen kriteret për dhënjen e kontratës,andaj OE.ankues pretendon se AK-së e ka shkelur ketë nenë duke e shperblyer me kontratë OE. të pa përgjegjëshëm .

Ekspertja thekson se pretendimi është pjesërisht i bazuar sepse është shperblyer me kontratë OE.pa u siguruar se është tenderi tenderi i përgjegjëshëm me çmim ma të ulëtë.

Andaj,
Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5 dhe 6
Operatori Ekonomik ankues " ALFA.I SH.P.K"-pretendon se Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 64 dhe 69 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Eksperja thekson se qellim i nenit 64 është të deshmohet me çertifikatë apo me deshmi tjera lidhur me kriteret e vendosura në NJ.K. dhe DT.
Eksperja thekson se qellim i nenit 69 të LPP-së është që të plotsohen kerkesat nga aftesia teknike dhe profesionale .

Siqë është sqaruar me pergjigjejet nr 3 ekspertja edhe një here thekson se keto pretendime janë pjesërisht të bazuara sepse siq i kam përmendur dy çertifikata ISO 9000:2015 dhe ISO 9004:2015 .nuk janë bashkangjitur në dokumentacionin e Operatorit të shpallur fitues kurse kriteret tjera i ka plotësuar dhe pretendimet në qdo aspekt tjeter janë të pa bazuara

Andaj,
Ekspertja konstaton se keto pretendime janë pjesërisht të bazuara.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesen e Operatorit ekonomik ta APROVOJË SI PJESËRISHT TË BAZUARË (për arsyet që u cekën tek përgjigjëjet në secilin pretendim) dhe i rekomandon panelit shqyrtues që lënda të kthehet në Ri-vlerësim .

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E ISTOGUT. .**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues - **ALFA.I SH.P.K"-**